



Në bazë të dispozitave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25 nga neni 23 paragrafi 1 dhe 2 nga Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25, Vendimi për kushtet e shpërndarjes dhe përdorimit të mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026, nr. 57-114/10 nga data 03.02.2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.24/26) dhe Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2026, nr.57-1046/9 nga data 24.02.2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 43/26) si dhe në lidhje me nenin 49 paragrafi 1, 2 dhe 3 nga Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 52/10, 135/11, 55/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 239/22), si dhe neni 4 i Kodit të praktikave të mira për mbështetje financiare të shoqatave qytetare dhe fondacioneve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 130/07), Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, shpall:

THIRRJE PUBLIKE **për mbështetje financiare të shoqatave dhe fondacioneve**

1. Qëllimi i thirrjes publike

Qëllimi i thirrjes publike është sigurimi i mbështetjes financiare për programe/projekte të organizatave joqeveritare në përputhje me Programin për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2026.

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 të përcaktuara në Seksionin 04010 - Ministria e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami 11 – Promovimi i marrëdhënieve ndëretnike, pika 463 – Transferimet për organizatat joqeveritare, të cilat janë të destinuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve kryhet në përputhje me Programin.

2. Përshkrimi i Programit

Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve është i orientuar drejt forcimit të bashkëpunimit me sektorin civil si partner kyç për zhvillimin e kulturës së pjesëmarrjes së tyre në sferat e jetës shoqërore dhe në krijimin e politikave publike, si dhe për promovimin dhe avancimin e marrëdhënieve ndëretnike.

3. Lloji i programeve/projekteve të cilat do të mbështeten

Thirrja publike shpallet për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për programe/projekte të cilat do të përfshijnë disa nga qëllimet në vijim:

A) Qëllimet prioritare:

- barazi dhe mosdiskriminim në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe eliminimin e gjuhës së urrejtjes dhe jotolerancës;
- përmirësimi i kohezionit social dhe ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse;
- sigurimi dhe promovimi i vlerave të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (identiteti etnik, kulturor, gjuhësor i bashkësive);
- ndërtimi i një shoqërie shumëkulturore me qëllim zbatimin me sukses të programeve të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës;
- sundimi i së drejtës, pavarësia e gjyqësorit, luftë pa kompromis kundër krimit dhe korrupsionit me transparencë të gjerë dhe obliguese;
- avancimi i arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive në arsimin fillor dhe të mesëm në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- informimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive sferën publike dhe në njoftimet mediatike.

B) Qëllimet specifike:

- zvogëlimin e distancës etnike dhe eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit kombëtar dhe fetar;
- promovimi i karakterit multietnik të shoqërisë, ndërtimi i besimit dhe bashkëjetesës, bashkëpërgjegjësi për të ardhmen e përbashkët të anëtarëve të bashkësive në nivel qendror dhe lokal;
- avancimin e sistemit të vlerave që bashkon interesat, nevojat dhe aspiratat e të gjithë qytetarëve, gjë që do të kontribuonte në një atmosferë pozitive socio-kulturore dhe kushte pozitive politiko-ekonomike për realizimin e nevojave themelore të individit dhe potencialit kolektiv;
- zbatimin e parimeve të cilat burojnë nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit;
- zbatimin e të drejtës për përdorimin e gjuhëve të anëtarëve të bashkësive në përputhje me ligjin;
- promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore të anëtarëve të bashkësive;
- promovimi dhe avancimi i respektit për identitetin e anëtarëve të bashkësive;
- avancimi dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe një mjedisi të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave themelore;
- bashkëpunim dhe veprim i përbashkët me efektiv midis strukturave kombëtare të të drejtave të njeriut, partnerëve social, organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve qeveritare për të avancuar axhendën e të drejtave të njeriut;
- zhvillimi i një sistemi drejtësie që mbron në mënyrë efektive liritë, të drejtat e njeriut dhe një sistem të përbashkët vlerash;

- një luftë vendimtare dhe pa dallim kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, reforma drejt sundimit të ligjit dhe ndërtimit të institucioneve të pavarura;
- zhvillimi i arsimit me qëllim krijimin e individëve që do të respektojnë dhe vlerësojnë të drejtat civile, tolerancën; diversitetin, edukimin në frymën e multikulturalizmit dhe trajnimin për nevojat e tregut të punës, dhe
- informacion i përmirësuar mbi gjuhët e anëtarëve në mediat tradicionale dhe dixhitale, me qëllim njohjen e publikut të gjerë.

4. Korniza kohore dhe mjetet e përgjithshme të parapara / në dispozicion

Mjetet nga buxheti i Ministrisë së Marrëdhënieve ndërmjet Bahkësive, në një shumë totale prej 18.113.000,00 denarë, do të përdoren për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve përmes granteve deri në shumën prej 500.000,00 denarë. Pagesa e mjeteve të ndara do të bëhet pas nënshkrimit të kontratës dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në kontratën për ndarjen e mjeteve financiare.

Zbatimi i programeve / projekteve do të zgjasë më së voni deri më 30 nëntor 2026.

5. Kushtet themelore për konkurim

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në Thirrjen publike duhet të plotësojnë kushtet në vijim:

- të jenë të regjistruara në pajtim me dispozitat e Ligjit të Shoqatave dhe Fondacioneve të paktën një vit para publikimit të thirrjes publike,
- të mos kenë marrë mjete ose të kenë dorëzuar një kërkesë nga/deri te një organ tjetër i administratës shtetërore ose burime të tjera për të njëjtin qëllim dhe aktivitete për të cilat parashtrojnë kërkesë, që do të thotë financim i dyfishtë i aktiviteteve të njëjta nga burime të ndryshme,
- të kenë dorëzuar raport mbi përdorimin e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për aktivitete programore për vitet e kaluara,
- të mos kenë ndalesë për të përdorur mbështetje nga shteti në përputhje me nenin 52 nga Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.

Dispozita e paragrafit 1, pika 3 e këtij neni nuk i referohet kërkesave për kompensimin e pjesës për bashkefinancimin e projekteve të Bashkimit Evropian nga përdoruesit përfundimtarë.

6. Vlerësimi i cilësisë së programeve / projekteve

Vlerësimi i cilësisë së programeve/ projekteve të shoqatave dhe fondacioneve të cilat i plotësojnë kushtet themelore do të kryhet në bazë të kriterëve të posaçme programore:

Kritere	Pika maksimum
1. Vlerësimi i kapaciteteve të shoqatës/fondacionit	20
1.1. Struktura organizative dhe burimet për zbatimin e projektit (të punësuar, vullnetarë aktivë ose të punësuar me honorare, hapësirë zyre, pajisje teknike dhe aftësi për të zbatuar buxhetin)	10
1.2. Përvojë e dëshmuar në fushën (qëllimi prioritar) me të cilën ka të bëjë propozimi i projektit	10
2. Bashkëpunim dhe rrjetëzim	5
2.1. Anëtarësim në rrjete dhe platforma të organizatave qytetare (kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe projekte të zbatuara në bashkëpunim me organizata ose organe të tjera të administratës shtetërore	5
3. Kualiteti i projektit	50
3.1. Kontributi i projektit në arritjen e qëllimit të caktuar prioritar dhe qëndrueshmërinë e projektit	10
3.2. Arsyetimi për nevojën për të zbatuar projektin	10
3.3. Aktivitetet e propozuara të arrijnë deri te realizimi i rezultateve të parashikuara në projekt.	10
3.4. Plan i qartë, i arritshëm, i matshëm dhe realist për zbatimin e projektit	10
3.5. Tregues të përcaktuar qartë për matjen e arritjeve	10
4. Buxheti dhe efikasiteti i shpenzimeve	20
4.1. Pajtueshmëria e mjeteve të kërkuara me aktivitetet e planifikuara dhe justifikimi i shumës së kërkuar të mjeteve	10
4.2. Përputhshmëria e shpenzimeve të planifikuara me rezultatet e pritura	10
5. Pikat për nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal në përputhje me Vendimin për klasifikimin e rajoneve planifikuese sipas nivelit të zhvillimit për periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2028 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 262/24), të miratuar në bazë të Ligjit për Zhvillim të Barabartë Rajonal (*).	5

7. Dokumentacioni i nevojshëm i cili duhet ta dorëzojë shoqata/ fondacioni

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në shpalljen publike duhet të dorëzojnë në vijim:

1. Fletëparaqitje për mbështetje financiare e nënshkruar nga personi i autorizuar dhe e vërtetuar me vulë;
2. Propozim – projekt i nënshkruar nga personi i autorizuar dhe i vërtetuar me vulë;
3. Gjendja rrjedhëse nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridik për regjistrimin e shoqatës / fondacionit, jo më të vjetër se gjashtë muaj, original ose e vërtetuar në noter;
4. Kopje të statutit;
5. Kopje të llogarisë përmbyllëse (bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit) për vitin paraprak ose vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut që në vitin paraprak kanë realizuar të ardhura më pak se 2,500 euro në kundërvlerë të denarit sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e dorëzimit të fletëparaqitjes;
6. Raport për punën me qëllime, aktivitete, rezultate dhe burime të financimit në vitin paraprak;
7. Deklaratë nga personi i autorizuar i shoqatës ose fondacionit se nuk janë siguruar mjete për të njëjtat aktivitete nga burime të tjera;
8. Deklaratë nga personi i autorizuar i shoqatës ose fondacionit se nuk janë marrë mjete buxhetore për të njëjtin projekt në vitin aktual;
9. Deklaratë mbi strukturën themeluese nga themeluesi/personi i autorizuar i shoqatës ose fondacionit në përputhje me nenin 52 nga Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Formularët: Fletëparaqitja për mbështetje financiare, Propozim projekti dhe Deklarata për strukturën themeluese janë në dispozicion në **web-faqen** e Ministrisë së Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive www.moz.gov.mk

Vërejtje: Formularët duhet të dorëzohen detyrimisht në gjuhën maqedonase. Krahas gjuhës maqedonase, formularët mund të dorëzohen edhe në çdo gjuhë tjetër që flitet nga të paktën 20% e popullsisë, në përputhje me ligjet pozitive në fuqi.

Shoqatat dhe fondacionet **nuk mund** të dorëzojnë më shumë se një fletëparaqitje për mbështetje financiare sipas shpalljes.

Fletëparaqitjet me dokumentacion të paplotësuar nuk do të shqyrtohen.

Fletëparaqitjet të cilat do të dërgohen pas afatit të caktuar nuk do të shqyrtohen.

Dokumentacionet bashkangjitur të cilat dorëzohen nuk do të kthehen.

Të drejtë në pjesëmarrje nuk kanë shoqatat dhe fondacionet të cilat në tri vitet e kaluara kanë qenë përfitues të mjeteve financiare nga Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, por nuk i kanë përmbushur plotësisht detyrimet të cilat rrjedhin nga kontrata, përkatësisht nuk e kanë arritur qëllimin e kontratës.

8. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikacioneve

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 30 ditë nga dita e publikimit të Thirrjes publike.

9. Mënyra e dorëzimit të aplikacioneve

Fletëparaqitja me të gjithë dokumentacionin duhet të dorëzohet në një zarf të veçantë të mbyllur me shënimin "Aplikim me të gjithë dokumentacionin". Një shkresë përcjellëse duhet të dorëzohet së bashku me zarfin e mbyllur që përmban aplikimin me të gjithë dokumentacionin. Më pas, materiali dorëzohet në një zarf tjetër të mbyllur me shënimin "Shpallje për mbështetje financiare të shoqatave dhe fondacioneve nëpërmjet postës", në adresën:

Ministria e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive
Rr: "Filipi i Dytë i Maqedonisë" nr.11
1000 Shkup

ose personalisht në arkivin e Ministrisë së Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, në ditët e punës nga ora 08:00 deri në 16:00.

Pyetje për sqarim mund të parashtrohen në ngo@moz.gov.mk deri më datën 23.03.2026.

Shoqatat dhe fondacionet pjesëmarrëse në shpallje publike do të njoftohen për rezultatet në afat prej 10 ditësh nga dita e miratimit të Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve.